



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-214271/23 më 01. 11. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008), nenit 4 dhe 7 i Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë , pika 8 e Qarkores e Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr.Ref.356/2023 të datës 21.03.2023 rrethë zbatimit të Rregullore (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë dhe nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës me numër protokolli Nr.110-391 te dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET, vendimi për ekzekutimin e pagës për kompensimin e punës të Komitetit të Auditimit të Komunës së Prishtinës.
- II. OBLIGOHET, Drejtoria për Financave që konform Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komitetit të Auditimit të Komunës së Prishtinës Nr. 14-020/04-159560/23 të datës 03.08.2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendim Nr. 14-035/01-176543/23 të datës 25.08.2023, të bëjë kompensimin e anëtarëve dhe sekretarit të Komitetit për Auditim prej 30% të pagës bazë të Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës për kryesuesin e Komitetit dhe 20% për anëtarët e komitetit dhe sekretarit të komitetit sipas listës dhe procesverbalit të takimeve të Komitetit të Auditimit të Komunës së Prishtinës.

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria e Financave.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

U dorëzohet:

- Kryesueses dhe anëtarëve të Komitetit të Auditimit;
- Drejtorit të NJAB (Sekretarit të Komitetit të Auditimit);
- Drejtorisë së Financave;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

